




**REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA -REPUBLIC OF KOSOVO**

Prokuroria Themelore Prishtine -



Numri i dokumentit: 00821823


ZYRA E PRANIMIT

MUHAMETMUJAJmë datën 28.05.2020në ora 13:07 në Prokuroria Themelore Prishtine dorëzoi këto dokumente:

Lloji i dokumentit	Nr. i dokumentit	Data e dokumentit	Nr. i faqeve
Kallëzim Penal		28.05.2020	29

Tjera:

Dorëzoi:


0282020 01:58:33 pm

Pranoi:



MUHAMETMUJAJ

Besnik Halimi

PROKURORISË THEMELORE NË PRISHTINË

DEPARTAMENTI I PERGJITHSHËM

Konform nenit 79 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës paraqes këtë:

KALLËZIM PENAL

Kuñdër Gani Mehmetaj i lindur në vitin 1955 në fshatin Dubovë të Pejës, me veçbanim në Prishtinë, ka të kryer shkollimin universitar, me profesion gazetar, shkrimitar, dramaturg, kineast, për momentin producent dhe Drejtor i "Kosovafilmit" si dhe profesor në Universitetin Publik të Prishtinës "Hasan Prishtina",

S E P S E

Ekziston dyshimi i arsyeshëm se Gani Mehmetaj, me profesion gazetar, shkrimitar, dramaturg, kineast, me datën 20.05.2020 në profilin e tij në Facebook me emrin Gani Mehmetaj me adresë www.facebook.com/gani.mehmetaj, ka publikuar një shkrim duke shkaktuar dhe shprehur publikisht urrejtjen ndaj komunitetit mysliman.

Me çka ekziston dyshim i arsyeshëm se i njëjti me veprime të tilla ka kryer veprën penale Nxitja e përçarjes dhe mos durimit nga neni 141 par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

I lartcekuri ne mënyrë sistematike, qoftë përmes shkrimeve të tija në gazeta dhe portale nxit urrejtje, përçarje dhe mosdurim fetar e në veçanti veprime të tilla të drejtuara ndaj komunitetit fetar të besimit islam. Përmes shkrimeve të tija publike ai nxit urrejtje, ndjenjë armiqësore ndaj pjesëtarëve të fesë, intensiteti i së cilës është i tillë i cili nuk e përjashton mundësinë që të shkaktohet ndonjë e keqe. Nga urrejtja që ai shpreh e që rrjedh nga gjendja e tij psikologjike e superioritetit se ai e ruan substancën e kombit shqiptar dhe se të tjerët nuk kanë merita të tillë, mendime të tillë që qojnë në krijimin e situatave konfliktuale midis feve gjendje këto të cilat mund të shkaktojnë pasoja të rënda. E me pas nga nxitja e tillë dhe urrejtja kemi përçarje, antagonizma dhe kundërshtime në mes të qytetarëve çdo herë këto me karakter fetar. Antagonizma, përçarje këto të shpehura në rrjete sociale e sigurisht edhe në jetën reale dhe të përditshme. Andaj veprimet e tij dergojnë deri të shkaktimi, përhapja, thellimi i urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit midis pjesëtarëve të feve të cilët jetojnë në Kosovë. Ky aktivitet i tij urrejtës është vërejt që nga viti 2017 e në vazhdimësi deri me tanë.

Duke qenë si i njëjti ushtron autorizime publike, ka qenë drejtor i "Kosovafilmit", kryen detyren e profesorit universitar, shkrimitar, gazetarit dhe ka peshë me shkrimet e tij dhe me veprat e tij, duke qenë si i njëjti është i përgatitur profesionalisht, ka ndjekës të shumtë në rrjete sociale dhe fjala e tij lexohet nga shumë ndjekës e lexues, i njëjti në mënyrë sistematike në profilin e tij personal facebook e me pas edhe në

shpërndarjen e tyre në shtyp ditor dhe elektronik shpërndan shkrime të tilla në drejtim të komunitetit mysliman,

A r s y e t i m

Më datë 20.05.2020, në profilin e tij në Facebook me emrin Gani Mehmetaj me adresë www.facebook.com/gani.mehmetaj, ka publikuar një shkrim e me pas të njëjtin shkrim e kanë marrë shumica e portaleve në rrjete sociale dhe faqe elektronike duke shkaktuar dhe shprehur publikisht urrejtjën ndaj komunitetit mysliman dhe besimtarëve të cilët janë praktikues të fesë Islame, duke i quajtur besimtarët që janë fal në rrugë si "krahun islamik të Isosit, kur dolën me një copës beze të faleshin si beduinët në shkretëtirë" duke kërcenuar me fjalët "Po u falët në rrugë do t'u rrah si qentë", ofenduar dhe etiketuar me emra kafshësh. Shkrimi vazhdon duke i quajt me lloj-lloj terma që nxisin përçarje dhe mosdurim në baza fetare me fjalët "Islamiket e ulën bishtin dhe ikën", "duke i ngrehur të prapmet drejt qiellit në Sheshin "Gjergj Kastrioti- Skënderbeu", se ata janë të rrezikshëm për shëndetin e qytetarëve, se rrezikojnë kombin dhe rendin, se do të përhapin virusin si minjtë koleren dhe fjalë të tjera të cilat kanë shkaktuar një reagim të madh ndër qytetar, kanë shkaktuar polarizime të atilla në shoqëri e që mjafton të hapesh mjete elektronike të informimit dhe rrjete sociale ku qytetarët i ka ndarë në grupe të cilat shprehin mllefin dhe reagimet e tyre polarizuese e që janë të rrezikshme për një shoqëri demokartike dhe për një shoqëri çfarë jemi ne, me tolerancë, diverzitet dhe multifetarizëm. (Bashkëngjitet shkrimi i tij i marrë nga faqja e tij facebook)

Ky reagim i tij me shkrim me të cilin ka kërcenuar e ofenduar rëndë komunitetin mysliman e sidmos besimtarët të cilët me datë 19.05.2020, në shenjë proteste për mos hapjen e xhamive kanë falur namazin e ikindis në "Sheshin Skënderbeu" në Prishtinë. I njëjtë ka kërcënuar besimtarët mysliman duke cituar kinse fjalët e ish-Kryeministrit Bajram Rexhepi, në një bisedë që pretendon ta ketë pasur me të me fjalët "Po u falët në rrugë do t'u rrah si qentë". Gjatë shkrimit të tij i dyshuar besmitarët musliman i cilëson si përkrahës apo krah i ISISIT dhe i krahason me beduinët në shkretëtirë, kjo për ti nënqmuar dhe për ti përbuzur besimtarët mysliman.

I dyshuar ka shprehur fjalë të rënda për besimtarët duke ju drejtar me fjalët "Dje islamikët e Partise Demokratike të Kosovës, e provokuan rëndë rendin dhe qëtësinë, e rrezikuani shëndetin publik duke i ngrehur të prapmet drejt qiellit në Sheshin "Gjergj Kastrioti- Skënderbeu".

Fyerjet e tij kanë vazhduar me fjalët "Shteti nuk duhet të lejone cirk-faljen, nuk duhet të ligështohej para islamikëve të Isosit, duhet të mbronte jetën e shëndetin e qytetarëve. Shteti nuk duhet t'ua luaj bishtin, por ti godas. është në rrezikjeta e kombit sepse ata që do të falën në xhami a në shesh, pastaj do ta përhapin virusin si minjtë kolerën".

Ne fund i dyshuar besimtarët të cilët kanë faluar namazin i krahason me qenët duke thënë "Pamja nga ku u falën dje islamikët, pasdite u vërshuan nga qentë".

Ky shkrim i tij publik me pas është shpërndarë nga portalet online si: Indeksonline, Korresponenti, KorrektShow, Periskopi e faqe të tjera të cilat me pas janë komentuar nga mijëra qytetar. (Shkrimet e nxjerra nga këto faqe)

I dyshuar Gani Mehmetaj, gjatë gjith kohës, në mënyra të ndryshme, qoftë përmes rrjetit social facebook apo përmes publikimit të shkrimeve në gazeta të ndryshme bënë nxitje për urrejtje, përçarje dhe mosdurim të myslimanëve në Republikën e Kosovës, sidomos besimtarëve të cilët janë praktikues të fesë Islame, kjo vërtetohet nga provat e bashkangjitura në këtë kallëzim penal.

Për gjuhën e tij urrejtëse ka reaguar se fundmi edhe KLMDNJ, po ashtu kemi has në Raportin Evropian të Islamofobisë të vitit 2018 se i dyshuar si gazetar që përhap lajme të dëmshme dhe nxitëse për komunitetin mysliman duke e vequar atë të publikuar me datë 9 janar 2019 në "Bota Sot" me titullin "Shqiptarë Lindësh, Myслimanë Bëhesh!", duke iu referuar në shkrime shqiptarëve mysliman si arab me qëllim të shfaqjes se tyre si negativ i shoqërisë. (Bashkangjitur keni faqën e raportit Evropian në gjuhën angleze)

Shkrime të tilla në faqen e tij dhe të shpërndara me pas në portale e gazeta hasen që nga viti 2017 e ndoshta edhe me herët si:

"Moda beduine e iftareve në rrugë e në çadra" e datës 11 qershor 2018 duke i quajtuar organizatorët e iftarit në Dardanë si "modën beduine të iftareve në rrugë e filluan shoqatat vehabiste-terroriste, e vazhduan shoqatat tjera islamike të burimeve të dyshimta financiare, ndërsa tash në organizimin e iftareve mbizotëron KFOR-i turk e ambasada turke", duke i përshkruar qytetarët tanë "të veshur keq si të ishin në shkretëtirën arabe", se "Zhuga e darkave beduine (iftareve) i ka infektuar edhe disa kategori të intelektualeve".

Shkrimi i datës 28 maj 2018 "Të largohet KFOR-i turk nga vendi ynë!" ky një shkrim me plotë fyerje të rënda të minoritetit turk dhe ushtarëve turk të KFOR-it duke i quajt me lloj-lloj epitethesh duke i quajtuir taleban e ardhacak nga Anadolli e me pas duke i apostrofuar se bashku me ta edhe besimtarët vendor. Datë 16 janar 2017 "Kufoma e osmanizmit i qelbi shqiptarët", 16 dhjetor 2017 "A janë shqiptarët islamofobë?", 26 dhjetor 2017 "Mbi 98 për qind të shqiptarëve nuk janë myslimanë", 22 nëntor 2018 "Skandali i hoxhallarëve turq me djem të mitur", shkrime në të cilat mjaftohet që të lexohen dhe të shihet urrejtja e thirrja për qytetarët për të luftuar islamin dhe xhamitë të cilat sipas tij janë objekte nga të cilat ka vetëm prapambeturi, zhurma që dalin nga atoporlantët e xhamive që i terrorizojnë qytetarët me zërin e tyre sikur në vendet primitive arabe. I njëjti shkon aq larg me këto shkrime sa paraqet edhe racizëm të qartë duke përqesh popuj të téré të lindjes. Ai thërret haptas qytetarët për islamofobi me arsyetimin se të gjitha shtetet e botës janë islamofobe.

Gjatë vitit 2019 ka vazhduar të shpalos dhe nxis urrejtjen dhe mosdurimin fetar në disa prej shkrimeve: Datë 8 shkurt 2019 "Ideologjia islamike është nacionalizëm arab, ashtu si ideologjia komuniste ishte pansllavizëm rus", 17 qershor 2019 "A je

mysliman?" ku islamin e krahason me "zhugën, kolerën a mortajën", "Njolla e islamit shqiptarët e shkretë po i ndjek ngado që shkojnë". I dyshuarit gati në të gjitha shkrimet paraqet persona kinse i janë drejtuar atij me fjalë siqë është edhe rasti i një qytetari nga Mitrovica i cili i ankohej të dyshuarit për ndërtimin e një xhamie në "lagjen Sylanaj" në Mitrovicë e datës 19 korrik 2019 "Edhe kur mbëltohet një pemë duhet të merret mendimi i lagjes e lërë më kur ndërtohet një xhami që do t'i çmend banorët me britma e ulërima nga mëngjes deri natën vonë. Kush gjumë të qetë nuk do të bëjë po e lejuat xhaminë".

Apo dy shkrimet e datës 19 gusht 2019 "Ku nuk ka shkel këmba e Muhametit, myslimani nuk duhet të jetoj!" dhe shkrimi i datës 20 gusht 2019 "Katoliku është shtatë herë më i keq se shkau (serbi)!" duke i mvesh klerit fetar mysliman ligjerata e fjalë të pavërteta mbi raportin me të tjerët dhe përceptimin e tyre ndaj jetës, dy shkrime që janë tendencioze dhe që kanë qëllim rritjen e antagonizmave dhe urrejtjës ndaj njëri-tjetrit në shoqëri.

Shkrimi i dates 17 shtator 2019 "Nën flamurin e Muhametit" thëret për kinse rrezikun nga terroristët islamik që ka në çdo sferë shtetërore, duke përfshirë edhe BIK-un dhe xhamitë e besimtarët, tenton edhe atë pak organizim humanitar të "Jetimat e Ballkanit" ta njollos duke u shpreh ndaj hoxhës Kastrati "Këtë hoxhë, duan ta prezantojnë ndryshe nga islami primitiv i hoxhë Shefqetit, që u bë përrallë e objekt tallje të te rinjtë me primitivizmin e tij. Por hoxha zemër mirë më paratë e huaja, predikon xhihadin (luftën deri në shfarosje të jomyslimanëve) në rrjetet sociale pa i bërë syri verr" apo se të hollat që vijnë nga mafija islamike. Me këtë flamur siç e quan i dyshuarit "flamur që e mbajnë terroristë", ky flamur mbahet nga të gjitha institucionet, partitë politike e organizatat humanitare në Kosovë çdo herë kuptohet për ata që kanë përkatësi fetare islame.

Edhe gjatë vitit 2020 i dyshuarit shpreh urrejtje dhe e nxit atë me shkrimet e tija si: Ai i datës 29.03.2020 "Kali i Trojës në mesin e shqiptarëve!", ai i datës 18.04.2020 "Korbat e islamit sillën mbi Dardani", datë 12.05.2020 "Kur i varfëri agjeron, i pasuri gëzon!" shkrome të cilat haptazi fyejn identitetin fetar dhe i quajnë myslimanët si "He për he janë dele të shushatura, por mund të bëhen ujqër të çartur". Fjalët e tillë ujqër, qenë, deve, minjë e shumë fjalë tjera me emra shtazësh për një bashkësi fetare janë sa neverikosëse aq edhe nxitëse, apo duke e krahasuar fenë islame me sëmundje të ndryshme ngjitetëse. Shkrimi i parafundit është ai i datës 18 maj 2020 "Për njëzetë vjet shqiptarët ndërtuan 800 -1000 xhami dhe, asnjë teatër!" duke shpreh millefin e tij ndaj ndërtimit të xhamive dhe atyre ekzistuese me fjalët "Ku po vete shoqëria jonë e xhamive, mesjetës shkretinore dhe e klikës sunduese të korruptionit të skajshëm".

Në shkrimet e të dyshuarit nuk mungojnë etiketimet, fyjet e sharjet edhe ndaj gjinisë femërore. Disa prej fjalëve në shkrimet e të dyshuarit: Shkrimi i datës 14 shkurt 2018 "A ishin gratë e mbuluara viktima të dhunës në familje?", ku ai shprehet për gratë dhe femrën me përkatësi islame duke e shfryer rrëfimin e tij ndaj islamit me personazhe të tija të zakonshme kinse dy vajza i kanë treguar se i kanë ik familjes dhe nuk kanë pranuar të veshën me ato rroba fetare. Se ato vazhdojnë jetën të lumtur meqë kanë studiuar dhe shkolluar, rrëfimin e tij se kinse femrat mbulohën me dhunë dhe janë pjesë e dhunës në familje. "Vlora dhe Merita janë disa nga shembujt e ndritshëm

që shpëtuan nga kthetrat e dhunës mesjetare arabe. Por sa vajza e gra nuk e patën forcën e vendosmërinë e Vlorës e Meritës që t'i shpëtojnë errësirës arabe e dhunës familjare?", i dyshuar në këtë shkrim ka të publikuar edhe një fotografi me femra të mbuluara. Ai e konsideron mbulesën si kolera. Apo shkrimi i datës 10 shkurt 2018 "Shpërfytyrimi I Violeta Zefit Dhe Grave Të Mbuluara" ku e paraqet në dy fotografi këngtarën e cila ka pranuar islamin me fjalët " Çfarë drame, çfarë fatkeqësie mund t'i ketë rënë mbi kokë një gruaje, zonje të rëndë shkodrane e artisteje sa të kthehet në kopenë e grave të kohës së gurit?!", apo "gra të mbuluara beduine të nënshtuara si dele".

Si dhe shkrimi i fundit në të cilin vetëm se e kemi sqaruar në fillim të kallëzimit i cili përpos titullit nënqmues, nxitës për urrejtje, mosdurim, i bashkangjetë edhe fotografi me qenë.

Duke qenë se jemi shoqëri demokratike e cila ndërtohet me shtet ligjor dhe si kusht për ndërtimin dhe funksionimin e një sistemi juridik demokratik dhe të qëndrueshëm në mesin e të cilave është njohja dhe respektimi i diversiteteve të grupeve kombëtare, racore, fetare apo etnike. Njohja dhe respektimi i këtyre veçorive, sipas konventave ndërkombëtare dhe të të drejtave nationale, bën pjesë në liritë dhe të drejtat themelore individuale dhe kolektive. Për këtë arsyе nxitja e urrejtjës, e përçarjes ose e mosdurimit në baza të veçorive të tilla do të duhej të fillohej sipas detyrës zyrtare meqë konsiderohet vepër penale.

Si provë materiale janë të gjitha shkrimet e tija të printuara e të siguruara nga profili i tij dhe nga portalet e ndryshme që i kanë publikuar të njëjtat.

Nga sa u tha më lartë, nuk është kontestuese se Gani Mehmetaj, është i përfshirë në kryerjen e veprës penale nxitja e përçarjes dhe mosdurimit nga neni 141 par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, andaj në këtë çështje penale konsideroj që ka prova të miaftueshme për ngritjen e aktakuzës nga ana e Prokurorisë.

Kallëzimit i bashkëngjiten: Shkrimi i fundit i datës 20.05.2020, shpërndarjet që i janë bërë lajmit të fundit, lajmet e tri viteve që kanë të bëjnë me këtë vepër penale dhe fletë nga Raporti Evropian i vitit 2018 për islamofobinë.

Prishtinë,

28.05.2020

Paraqitësi i kallëzimit penal

OJQ STUDENTI IDEAL

Të përfaqësuar nga avokatet:

